

BULETINI I SHKOLLËS

Nëntor - Dhjetor 2024

ISH-NXËNËSIT TANË NDEROHEN ME MEDALJEN E ARTË

13 ish-nxënës të shkollës sonë u nderuan me Medaljen e Artë në një ceremoni të organizuar nga Kryeministri, Ministrja e Arsimit dhe Ministrja e Rinisë.

Përkushtimi dhe puna e tyre e palodhur u shpërblyen, duke i bërë ata fitues të çmimit më të lartë që mund të marrë një nxënës.

I urojmë sinqerisht ata, prindërit e tyre dhe të gjithë mësuesit për këtë arritje të jashtëzakonshme.



TAKIMI ME GRIDA DUMËN

Politikania Grida Duma zhvilloi një takim frymëzues me gjimnazistët, duke diskutuar rëndësinë e arsimit dhe zhvillimin e aftësive kritike.



INFORMACION MBI STUDIMET NË ITALI

Z. Sergio Alias, Sekretar i Parë i Ambasadës Italiane, informoi maturanët për mundësitë dhe procedurat e studimit në universitetet italiane.



TAKIM ME ISH- PRESIDENTIN ALFRED MOISIU

Z. Moisiu ndau histori frymëzuese nga periudha historike shqiptare dhe theksoi vlerën e pavarësisë.



ÇMIME PËR ARRITJE AKADEMIKE

Eron Zenelaj dhe Rubin Bekteshi u vlerësuan për sukseset në Olimpiadat Kombëtare nga Ministria e Arsimit.



UDHËTIM NË ISLANDË

Nxënësit e National Geographics Club eksploruan bukuritë natyrore dhe kulturën unike të Islandës.



SIGURIA KIBERNËTIKE DHE NDËRGJEGJËSIMI ONLINE

Autoriteti i Sigurisë Kibernetike trajtoi temën e bullizmit online me mësuesit, nxënësit e prindërit, duke u ndalur te mënyrat e shmangies së rreziqeve që vijnë nga teknologjia.



VIZITË NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE FILOLOGJISË

Senatorët e shkollës u njohën me bibliotekën universitare dhe shkencën e gjeografisë në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë.



EKSPERIENCA NË FUSHËN E MJEKËSISË

Nxënësit e Klubit të Mjekësisë vizituan spitalin Hygeia dhe mësuan mbi proceset diagnostikuese.



ROLI I MEDIAS SË LIRË NË SHOQËRI

Gazetarja Ermira Çauholli ndau me nxënësit e Klubit të Artit dhe të Medias rëndësinë e informimit të saktë dhe sfidat e gazetarisë.




KONKURSI "COLORS OF VOICES 2025"

Regjistrimet janë hapur për konkursin ndërkombëtar të këngës "Colors of Voices 2025", i organizuar nga Institucionet Arsimore "Turgut Ozal" dhe IFLC, ku fëmijët mund të shfaqin talentet e tyre dhe të bashkojnë kultura të ndryshme.

PANAIRI I LIBRIT 2024

Nxënësit Klubit të Debatit, Klubit të Medias e Artit dhe Klubit të Fotografisë vizituan stendat e shtëpive botuese dhe morën pjesë në promovimin e librit të Fatos Kongolli.



DITËT E MIRËSISË DHE TOLERANCËS

Shkolla rikujtoi rëndësinë e dashamirësisë, duke shprehur mirënjohje për mësuesit dhe stafin që kontribuojnë në një ambient të sigurt dhe të bukur.

BOTIMI I LIBRIT NGA ADEA BAJRI

Adea Bajri, nxënëse e shkollës, ka botuar librin e saj të dytë me poezi dhe e ndau këtë arritje me lexuesit gjatë një aktiviteti.

AKTIVITETI KUNDËR BULLIZMIT

Më 21 nëntor, shkolla organizoi një aktivitet për të luftuar bullizmin, ku nxënësit veshën bluza blu dhe dhuruan libra për bibliotekën e shkollës.

DHURU NJË LIBËR

MBROJTJA E LIRISË SË SHTYPIT

Klubi i Artit dhe Medias organizoi një takim me Drejtorin e Informacionit në Top Channel, z. Robert Rakiplari, mbi lirinë e shtypit dhe të drejtat e njeriut.

CEREMONIA E MEDALJEVE ASEF SOCIAL

Në ceremoninë e ndarjes së medaljeve, u vlerësuan nxënësit për kontributet e tyre në projektet sociale dhe ndikimin pozitiv që kanë pasur në shoqëri.

TAKIMI ME DREJTORIN E SHËRBIMIT SOCIAL

Shkolla mirëpriti Drejtorin e Shërbimit Social të Tiranës, z. Alfred Muharremi, i cili ndau eksperiencat e tij dhe mesazhin për mirënjohje dhe respekt ndaj prindërve.

Takimi me Enxhi Nasufin

Enxhi Nasufi, një figurë nga bota e ekranit, ndau me nxënësit e Awareness Club këndvështrimin e saj mbi bullizmin dhe ndikimin e tij në shoqëri, duke inkurajuar të rinjtë të përballen me të.



Takimi me atletën Luiza Gegën

Nxënësit takuan atleten Luiza Gega, e cila ndau përvojat dhe sfidat e saj në rrugën drejt suksesit ndërkombëtar, duke frymëzuar ata për të arritur ëndrrat e tyre.





FESTIMI I PAVARËSISË DHE ÇLIRIMIT TË SHQIPËRISË

Shkolla "Turgut Ozal" festoi Pavarësinë dhe Çlirimin e Shqipërisë me aktivitete kulturore dhe përkujtime, duke theksuar vlerat që na bashkojnë si komb.



VIZITA E PËRFAQËSUESVE TË ARKIVËS SË SHQIPTAR

Përfaqësuesit e Arkivës së Shtetit Shqiptar diskutuan me nxënësit mbi funksionimin dhe ruajtjen e dokumenteve historike të rëndësishme.



TAKIMI ME HISTORIANEN NEVILA NIKA

Historiana Nevila Nika ndau me nxënësit detaje interesante mbi rrugëtimin e Ismail Qemalit dhe Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.




RËNDËSIA E LEXIMIT DHE VENDIMMARRJES

Një takim frytdhënës me zonjat Irena Toçi, drejtoreshë e shtëpisë botuese "Toena", dhe Xhoi Jakaj, drejtoreshë e akademisë "ZojArt" për rëndësinë e librit dhe kujdesin në vendimarrje në fazën e adoleshencës.



VIZITA E KLUBIT TË ARTIT DHE MEDIAS NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Nxënësit vizituan Universitetin e Arteve, duke eksploruar laboratorët artistikë dhe mjedisin e krijimit.



TRAJNIMI PËR HIGJENËN KIBERNETIKE

Në bashkëpunim me AKSK, shkolla organizoi një trajnim për sigurinë online, duke rritur ndërgjegjësimin për mbrojtjen digjitale.



VIZITA E KLUBIT TË BIZNESIT NË MUZEUN E BANKËS SË SHQIPËRISË

Nxënësit u njohën me historinë e parasë dhe evoluimin e sistemit bankar shqiptar.



PËRFAQËSIMI I SHQIPËRISË NË BRUKSEL

Shkolla jonë do të përfaqësojë Shqipërinë në Bashkimin Europian, duke vizituar Parlamentin Europian dhe duke ndarë kulturën e Shqipërisë.



DISEKSIONI I VESHKËS DHE SYRIT

Nxënësit e Klubit të Mjekësisë realizuan disekSIONIN e veshkës dhe të syrit, duke eksploruar strukturat e brendshme të këtyre organeve.



VIZITA NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE

Klubi i Artit dhe i Medias vizitoi Bibliotekën Kombëtare, ku u njohën me procesin e digjitalizimit të librave.



AKTIVITET PËR DHUNËN NË FAMILJE

Në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, u organizua një aktivitet për parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje.



VIZITA E KLUBEVE AWARENESS DHE SHPRESA NË ZALL-HERR

Nxënësit vizituan fëmijët e një shkolle në Zall-Herr, duke shpërndarë dhurata dhe krijuar momente gëzimi.

Vizita e Klubeve të Mjekësisë në Spitalin Pediatrik

Nxënësit e Klubeve të Mjekësisë shpërndanë dhurata në Spitalin Pediatrik të Tiranës, duke sjellë gëzim për fëmijët.

Nderimi për nxënësin që humbi jetën

Një minutë heshtje u mbajt për të nderuar kujtimin e një nxënësi që humbi jetën tragjikisht, duke theksuar rëndësinë e mjediseve të sigurta dhe pa dhunë.

Videokonferenca me Fotograf Arian Mavriqi

Klubi i National Geographic dhe i Fotografisë dhe Historisë morën pjesë në videokonferencë me Arian Mavriqin, duke mësuar mbi rëndësinë e mbrojtjes së natyrës.

Nxënësit tanë në aktivitetin "Pjesëmarrja e të Rinjve"

Nxënës nga kolegji "Turgut Ozal" morën pjesë në prezantimin e Raportit Kombëtar 2023, duke diskutuar sfidat dhe angazhimin e të rinjve në shoqëri.

URIMI PËR VITIN E RI 2025

Shkolla "Turgut Ozal" uroi nxënësit, prindërit dhe stafin për një vit të ri të mbushur me mundësi për mësim dhe arritje të reja.



Shkolla thekson rëndësinë e aktiviteteve të ndryshme që zhvillohen gjatë vitit dhe fton nxënësit të vazhdojnë të jenë të angazhuar dhe të kontribuojnë në to. Pjesëmarrja aktive e tyre është kyçe për zhvillimin e aftësive dhe përgatitjen për të ardhmen. Njëkohësisht, mbështetja e prindërve mbetet e paçmuar për realizimin e qëllimeve dhe suksesin e shkollës tonë.

Me respekt,
Ekipi i Shkollës "Turgut Ozal"

